

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 3, datë 7.2.2025

PËR MARRJEN NË PUNË TË PUNONJËSVE ME KOHË TË PJESSHME, NË QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DHE SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 8, të aneksit nr. 5, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”; të shkronjës “a”, pikës 4, të vendimit nr. 109, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

UDHËZOJMË:

1. Për mbulimin e aktivitetit të tyre, qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale punësojnë me kontratë të pjesshme mësimdhënës (instrukturë dhe mësues me kohë të pjesshme) veç atyre të organikës së miratuar.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional (AFP), bazuar në numrin e kurseve për qendrat e formimit profesional publik, si dhe nevojat për mësues në dispozicion në shkollat e mesme profesionale, miraton me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-n, numrin maksimal vjetor të instruktorëve/mësuesve në dispozicion për çdo qendër të formimit profesional publik dhe shkollë të mesme profesionale.

3. Numri maksimal vjetor i kurseve dhe instruktorëve me kontratë në total për qendrat e formimit profesional publik është përkatësisht, deri në 2,500 kurse të planifikuara në vit dhe deri në 350 instruktorë të përkohshëm në vit.

4. Numri total i mësuesve me kohë të pjesshme për shkollat e mesme profesionale është deri në 200 mësues në vit.

5. Angazhimi i punonjësve mësimor me kontratë të përkohshme pune në arsimin profesional bëhet me orë mësimore. Pagesa për instruktorët dhe mësuesit me kohë të pjesshme kryhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”. Orët maksimale të lejuara janë 14 orë në javë në shkollat e arsimit profesional. Orët javore llogariten si diferencë nga ngarkesa e personelit në organikë (me kohë të plotë). Shpenzimet për pagesën e tyre përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin vjetor të akorduar për ministrinë përgjegjëse për AFP-në.

6. Numri i instruktorëve dhe mësuesve në dispozicion me kohë të pjesshme detajohet çdo vit sipas qendrave të formimit profesional dhe shkollave të arsimit të mesëm profesional me urdhër të ministrit përgjegjës për AFP-në dhe dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë Financave dhe në degët përkatëse të thesarit.

7. Dega e thesarit të çdo rrethi, autorizon kryerjen e pagesës për instruktorët dhe mësuesit me kohë të pjesshme, pasi verifikon numrin e tyre.

8. Udhëzimi nr. 1 datë 13.1.2020, “Për punësimin dhe pagesën e instruktorëve dhe mësuesve me kohë të pjesshme, në qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, degët e thesarit në rrethe dhe ofruesit e arsimit dhe formimit profesional për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas bototimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj